**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA DURRËS**
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit**

Datë 22.12.2025

## RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit* **MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOKNDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN DHJETOR 2025.**

**Baza ligjore:**

Ligji nr.139, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligji nr. 68/2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar; Ligji nr.9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar; Ligji nr. 57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.115 datë 24.12.2024 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2025"; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 1, datë 11.02.2025 "Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6 % të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike si dhe për ato që do të trajtohen me fonde të buxhetit vendor".

**Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër** *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë në përputhje me aktet ligjore dhe të vendosë:

1. Miratimin e përfitimit të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë Durrës për 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) familje me një fond prej 601.004 (gjashteqind e një mijë e katër ) lekë.

| Nr | NJËSITË ADMINISTRATIVE | Nr | Lekë |
|---|---|---|---|
| 1 | Njesitë Administrative Durrës | 90 | 401.792 |
| 2 | Njësia Administrative Rrashbull | 14 | 60.006 |
| 3 | Njësia Administrative Sukth | 25 | 103.776 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 4 | Njësia Administrative Ishëm | 1 | 8520 |
| 5 | Njësia Administrative Katund i Ri | 5 | 19.980 |
| 6 | Njësia Administrative Manëz | 2 | 6.930 |
| | Shuma | 137 | 601.004 |

2. Familjet që përfitojnë në skemën e Ndihmës Ekonomike, nga të ardhurat e Bashkisë ndodhen në listën bashkëngjitur materialit.

3. Miratimin e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike për këtë muaj gjithsej -1- familje nga fondi i Bashkisë.

4. Miratimin e futjes në skemën e ndihmës ekonomike për muajin Dhjetor 2025 të 1 (një) familje, të cilat janë në nevojë, në kushte të vështira ekonomike, me probleme të ndryshme sociale dhe do të trajtohen me fond nga të ardhurat e Bashkisë Durrës në vlerën 2160 lekë.

5. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi 6 % i fondit të kushtëzuar 39 (tridhjetë e nëntë) familje me një fond 182.702 (njëqind e tetëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e dy) lekë. Ky fond do të jetë nga fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike.

**Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):**

Natyra e financimit është me të ardhurat e veta të bashkisë Durrës dhe nga fondi i kushtëzuar 6% për bllok ndihmën ekonomike.

**Drejtoria/Sektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:**

Drejtoria e Shërbimit Social.

**Impakti social/grupet që preken:**

Familjet të cilat jetojnë në territorin e bashkisë Durrës, të cilat përfitojnë nga fondi i kushtëzuar 6% dhe ato që janë në kushte të vështira ekonomike dhe që përfitojnë nga të ardhurat e bashkisë Durrës.

**A është objekt konsultimi:** *(PO/JO)*

*JO.*

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mblodhë më datë 22.12.2025, dhe shqyrtoi pikën nr. 6 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

______________________________________________

______________________________________________

Nënkryetari hapi mbledhjen për diskutimin
të pikës 6 të rendit të ditës. Pyeti të
pranishmit nëse kishin pyetje. Të pranishmit
[illegible] dakort për kalimin e projektaktit
për shqyrtim dhe vlerësim në mbledhjen
e Këshillit bashkiak.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

**T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:**

a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
b- Miratimin e projekt aktit
c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
e- ______________________________

**Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit**

| | |
|---|---|
| Kryetar | Edlira Shemsi |
| Zv/Kryetar | Florian Tahiri |
| Sekretar | Bledar Prizreni |
| Anëtar | Xhiliola Doçi |
| Anëtar | Denis Lika |